

LIGJ
Nr. 8952, datë 10.10.2002

PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË
*(ndryshuar me ligjin nr.10 066, datë 2.2.2009 dhe nr.10 328, datë 30.9.2010, nr. 11/2019, datë 5.3.2019,
nr. 89/2020, datë 9.7.2020)*

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ky ligj përcakton letërnjoftimin e shtetasve shqiptarë, me qëllim pajisjen e të gjithë shtetasve shqiptarë, personave pa shtetësi dhe shtetasve të huaj me qëndrim të përhershëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një letërnjoftim unik, kriteret për lëshimin e tij, si dhe përmbajtjen e këtij letërnjoftimi.

Neni 2

(Shfuqizuar fjalia e dytë e pikës 1, dhe shtuar pikat 3, 4, 5, me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

1. Letërnjoftimi i personave është dokumenti bazë, i përhershëm që shërben për identifikimin e shtetasve shqiptarë.
2. Çdo shtetas duhet të mbajë me vete letërnjoftimin.
3. Shtetasi aplikon për letërnjoftim elektronik në zyrat e aplikimit.
4. Letërnjoftimi tërhiqet nga vetë shtetasi në zyrat e aplikimit.
5. Procedura e aplikimit dhe dokumentet që paraqiten për aplikim përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.

Neni 3

(ndryshuar shkronja "a" e pikës 1, me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

1. Për pajisjen me letërnjoftim shtetasi duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
 - a) të jetë i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
 - b) të ketë mbushur moshën 16 vjeç.
2. Çdo shtetas që plotëson kushtet e mësipërme është i detyruar të pajiset me letërnjoftim, brenda afateve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

(ndryshuar me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010, shtuar një paragraf me ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020)

Letërnjoftimi elektronik lëshohet me afat 10 vjet nga data e lëshimit.

Për shtetasit që kanë mbushur moshën 75 (shtatëdhjetë e pesë) vjeç, letërnjoftimi elektronik

lëshohet pa afat.

Neni 5

(shtuar shkronja “ç”, me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

Shtetasi pajiset me letërnjoftim të ri kur:

- a) plotëson kushtet e nenit 3 pika 1 të këtij ligji;
- b) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në letërnjoftimin, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- c) vërtetohet nga organet përkatëse se letërnjoftimi i ka humbur ose i është vjedhur.
- ç) është dëmtuar.

Neni 5/1

(shtuar me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

Letërnjoftimi shpallet i pavlefshëm kur:

- a) ka të dhëna të mjaftueshme se mbajtësi i tij e ka siguruar në mënyrë të paligjshme;
- b) vërtetohen rastet e përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 5.

Neni 6

(ndryshuar me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

Letërnjoftimi është dokument identiteti, në të cilin janë pasqyruar qartë dhe shënuar me metoda informatike:

- a) përbërësit e gjendjes civile të shtetasit:
 - i) numri personal (nup);
 - ii) emri;
 - iii) mbiemri;
 - iv) shtetësia;
 - v) vendlindja;
 - vi) datëlindja;
 - vii) gjinia;
- b) fotografia e mbajtësit të këtij dokumenti;
- c) nënshkrimi i mbajtësit ose i kujdestarit ligjor;
- ç) elemente sigurie, brenda normave të Komunitetit European, numri i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 7

1. Shkelja e afateve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë. Të drejtën për vendosjen e gjobës e ka shërbimi i gjendjes civile.

2. Mënyra e vendosjes së gjobës dhe ankimi në gjykatë bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar.

Neni 8

Forma, modeli i letërnjoftimit dhe mënyra e shpërndarjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ligji nr.4172, datë 13.9.1966 “Mbi pajisjen e shtetasve me letërnjoftim”, ndryshuar me ligjet përkatëse, si dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Dispozitë kalimtare

(me ligjin nr.10 328, datë 30.9.2010)

Tarifat për pajisjen dhe ripajisjen me letërnjoftim elektronik janë të përcaktuara në kontratën koncesionare, ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.7.2008. Me përfundimin e kësaj kontrate, këto tarifa do të jenë objekt i përcaktimit nga ky ligj.

Dispozitë kalimtare

(me ligjin nr. 11/2019, datë 5.3.2019)

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimeve elektronike të shtetasve shqiptarë, të cilat janë lëshuar nga data 9.2.2009 deri në datën 31.12.2009 dhe që përfundon brenda vitit 2019, zgjatet deri në datën 31.12.2019.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3542, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**